



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE  
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 403/4 Prot.

Tiranë, më 31.01 2025

**URDHËR**

Nr. 20, Datë 31/01/2025

**PËR**

**NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR.13 , DATË 27.01.2025 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË LLOJEVE TË TESTEVE TË MATURËS SHTETËRORE DHE MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE 2025”**

Në mbështetje të Ligjit nr. 69, datë 21.06.2012, “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 78, datë 08.02.2006, “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta”, i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", i ndryshuar, të Urdhrit të përbashkët të Ministrit të Arsimit e Sportit dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.661, datë 01.12.2023, “Për miratimin e Rregullores për zhvillimin e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr.1, datë 09.01.2025, “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2025”,

**URDHËROJ**

1. Pika 1 e Urdhrit nr.13 datë 27.01.2025, në Tabelën 1, ndryshon si më poshtë:

*“Testit D3, në profilin Gjimnaz i shtohet lënda Gjermanisht niveli B2.”*

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe Institucionet Arsimore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Aida Myrto

